



Kushtet e përdorimit të aplikacioni “My IPKO” të ofruar nga “IPKO TELECOMMUNICATIONS SH.P.K”

1. Dispozitat e përgjithshme

- 1.1 Këto kushte udhëheqin të drejtat, obligimet dhe kushtet për përdorimin e aplikacionit mobil (në tekstin e mëtejme referuar si “**My IPKO**”), e cila është në pronësi të kompanisë IPKO Telecommunications LLC (në tekstin e mëtejme referuar si “**IPKO**”).
- 1.2 IPKO rezervon të drejtën të ndryshoj çdo pjesë të aplikacionit dhe fshirjen e çdo pjese të përmbajtjes pa ndonjë njoftim paraprak.

2. Kushtet e përdorimit të “My IPKO”

- 2.1 “**My IPKO**” nuk është i autorizuar veçanërisht për veprimtaritë e mëposhtme:
 - Asnjë diskriminim, për shkak të racës, përkatësisë kombëtare, fetare dhe politike dhe orientimit seksual;
 - Zbatimi i aktiviteteve në portal të cilat janë në kundërshtim me ligjet;
 - Përdorimi i shërbimeve të portalit për dërgimin e mesazheve të papërshtatshme;
 - Çfarëdo ngacmimi i përdoruesve përmes përdorimit të shërbimeve të IPKO-së.

3. Shërbimet dhe Qasja

- 3.1 Përdoruesit do t’i mundësohet përdorimi i aplikacionit “**My IPKO**” përmes telefonave mobil, me qasje në përmbajtje të aplikacionit i cili i mundëson kontrollimin e llogarisë së tij të telefonisë mobile, afatin e shfrytëzimit të numrit, Paket aktive, pikën zyrtare të shitjes më të afërt të IPKO’s, benefitet, të menaxhojë shërbimin “Rrethi Im, të bëjnë rimbushjen e llogarisë së tyre dhe të tjerëve nëpërmjet llogarisë bankare, do të ketë qasje në ofertat më të reja të IPKO’s dhe t’i aktivizojë me anë të “**My IPKO**”, pagesat e faturave të klientëve individual me faturim mujorë, nëpërmjet llogarive të tyre bankare (pagesat nëpërmjet llogarive bankare klientët mund t’i realizojnë me anë të të gjitha bankave në Kosovë).
- 3.2 IPKO nuk është përgjegjës për pagimin e shpenzimeve të shkaktuara në përdorimin e pajisjeve tjera mobile ose lidhjes së internetit apo transferimit të përmbajtjes, ose ndonjë dëmtimi për shkak të transferimit ose instalimit të përmbajtjes së prodhuar në telefonin mobil të përdoruesit.
- 3.3 Për blerjen e shërbimeve në “**My IPKO**” si aplikacion ku puna e paguar nëpërmjet terminaleve të telefonave mobil ose kur pagesa është e lidhur në SIM kartelën e përdoruesit, për këtë përdoren kushtet e veçanta të përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike të IPKO-së.
- 3.4 Shkarkimi i aplikacionit “**My IPKO**” si dhe shfrytëzimi i tij do të jenë pa pagesë.



- 3.5 Gjatë përdorimit të shërbimeve me pagesë në “My IPKO” apo gjatë përdorimit të përmbajtjeve me pagesë, përdoruesi për përdorimin e këtyre shërbimeve apo për qasjen në këto shërbime do të ngarkohet në bazë të çmimores së vlefshme për këto shërbime dhe në mënyrë, të cekura gjatë përdorimit ose qasjes ndaj shërbimit. Çmimorja për ofertat dhe shërbimet e blera nga përdoruesi me anë të “My IPKO” është e publikuar në portalin www.ipko.com.
- 3.6 Nëse gjatë porositjes së shërbimeve me pagesë apo përmbajtjeve nuk do të ceken ndryshe, çmimi për përdorimin e shërbimeve me pagesë apo për qasjen ndaj shërbimeve me pagesë do të ngarkohet përdoruesi, i cili përdor shërbime përmes abonimit, në faturën e tyre të rregullt mujore për përdorimin e shërbimeve të IPKO-së, përdoruesve të telefonisë mobile, shuma e pagesës do të zbritet nga mbetja në llogarinë e kredisë.
- 3.7 Gjatë përdorimit të shërbimeve me pagesë apo gjatë blerjes së përmbajtjeve për shkak të cilave natyra e shërbimit dhe mënyrës së qasjes në përmbajtje, ku kthimi i përmbajtjeve të pranuar nuk është i mundshëm, shpenzuesi nuk ka të drejtë të largohet nga kontrata, përpos nëse ligjet e aplikueshme e përcaktojnë ndryshe.
- 3.8 Nëse përdoruesi nuk i respekton këto kushte, atëherë IPKO mund t’ia ndërpres përdorimin e aplikacionit “My IPKO”, pa njoftim paraprak.

4. Kufizimi i garancive

- 4.1 IPKO do të punojë në “My IPKO” për sigurimin e informacioneve të reja, por përdoruesit e aplikacionit i alarmon që tekstet e karakterit informativ, nuk garanton dhe nuk merr kurrfarë përgjegjësie për saktësinë e tyre dhe tërë aplikacionit. IPKO nuk merr kurrfarë përgjegjësie për çfarëdo gabime në përmbajtje dhe korrektësinë dhe saktësinë e informatave të publikuara, deri te cilat ka ardh për shkak të mos përputhjes në kohë, të regjistrimit të gabimeve të të dhënave ose për shkaqe tjera. Të gjithë përdoruesit, përmbajtjen e publikuar dhe informatat përdoren në përgjegjësinë e tyre.

4.2 Profili “My IPKO”

Përdoruesi mund të shkarkojë aplikacionin në Play Store dhe App Store pa pagesë dhe të krijojë një llogari me anë të numrit të telefonisë mobile të IPKO’s . Llogaria mund të krijohet duke hyrë me numrin e telefonit, kodin të cilin e pranon përmes SMS-it, Emrin (username), fjalëkalimin.

- 4.3 Përdoruesi, i cili llogarinë e tij nuk ka dëshirë ta përdori, mund ta fshij atë.

5. Të drejtat autoriale

- 5.1 Përmbajtja në dispozicion në “My IPKO” nuk lejohet të shqyrtohet dhe të riprodhohet për qëllime jo-komerciale, komerciale, personale. Përmbajtja është pronë e IPKO’s dhe përdoruesi nuk përfiton në këto asnjë të drejtë pronësore, autoriale dhe të lidhura. Përdoruesi ka drejtë ta përdorin përmbajtjen vetëm për qëllime të parapara dhe për qëllime personale jo-komerciale.



Përmbajtjen nuk mund ta ndryshoj, ta transkriptoj, t'a ripublikoj apo ta zgjeroj as për qëllime komerciale as për ato jo-komerciale, pa leje të shkruar dhe të miratuar nga IPKO. Në rast të çfarëdo përdorimi të përmbajtjes të këtyre faqeve, duhet të ruhen të gjitha shenjat e të drejtave autoriale dhe të drejta të pronësisë industriale si dhe njoftime të tjera dhe paralajmërime.

5.2 Markat të cilat shfaqen në aplikacion janë marka të regjistruara tregtare në pronësi ose të licencuara nga IPKO. Çfarëdo përdorimi i këtyre markave është e ndaluar pa ndonjë pëlqim paraprak me shkrim nga pronari i këtyre të drejtave. Shenjat, të cilat nuk janë të regjistruara sikur marka, janë të mbrojtura në bazë të Ligjit të aplikueshëm.

6. Kushtet e privatësisë

6.1 Për përdorimin e disa pjesëve të aplikacionit duhet të lajmërohet me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Me regjistrimin në aplikacion, përdoruesi pajtohet që të gjitha informatat private të tij, të cilat i ka deklaruar gjatë procesit të krijimit të emrit të përdoruesit dhe me përdorimin e aplikacionit, përdoren në mënyrë dhe për qëllime të përshkruara në vazhdimësi të këtyre kushteve.

6.2 IPKO angazhohet që informatat personale të përdoruesit, të fituara përmes “My IPKO”, i ruan me kujdes dhe nuk i kalon ato te ndonjë palë e tretë.

6.3 IPKO është e angazhuar, që ta mbroj llogarinë e përdoruesit të “My IPKO”. Informatat për përdorimin e “My IPKO”, që do të mblidhen në mënyrë automatike dhe të cilat nuk mundësojnë kontrollimin e informatat personale, IPKO do t'i përdor për qëllim të përmirësimit të përdorimit të aplikacionit.

6.4 Informatat personale, të cilat përdoruesi i deklaroi gjatë procesit të krijimit të emrit të përdoruesit dhe gjatë përdorimit të “My IPKO”, do të përpunohen dhe do të përdoren për të siguruar informacione të drejtpërdrejta përdoruesit mbi shërbime të reja të portalit “My IPKO” dhe për kontrollimin e përdorueshmërisë së “My IPKO” dhe shërbimeve nga ana e përdoruesit, në përputhje me këto kushte dhe udhëzimet mbi përdorimin e shërbimeve.

6.5 Informatat personale do të mblidhen, përpunohen dhe të ruhen edhe një vit pas përdorimit të fundit të “My IPKO”, kur regjistrimi ka qenë i detyrueshëm me emër të përdoruesit, në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Dispozitat e Përgjithshme

7.1 IPKO nuk është përgjegjëse për mos funksionimin e rastit të aplikacionit, çdo pasaktësi e informatave dhe për çdo dëm që rezulton për shkak të informacioneve të pasakta dhe jo të plota, as për ndonjë mos funksionim të qasjes të internetit nga ofruesi.

7.2 Për shkak që në aplikacionin “My IPKO” ekzistojnë disa lidhje të caktuara të cilat nuk kanë bënë me aplikacion dhe janë përtej kontrollit të IPKO, IPKO nuk mund të garantoj dhe nuk mund të pranoj apo të marrë përgjegjësi ndonjë ankesë të tillë në lidhje me saktësinë e përmbajtjes të cilësdo faqe, për të cilën ofron lidhje apo referencë dhe nuk merr asnjë përgjegjësi për mbrojtjen e informatave në këto faqe.



Ulpans Neighborhood | Zija Shemsiu Str. | Nr. 34 | Prishtine | 10000 | Kosovë
T: 038 700 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com